



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:075044  
Datë: 06.01.2021  
Numri i dokumentit: 01390576

**PKR.nr.79/20**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale kundër të pandehurit E. R nga Gjilani, të cilin e mbron mbrojtësja me autorizim av. Fjolla Ukshini nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së, dhe vepra penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRPK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.I.nr.76/2020, të datës 29.06.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 28.12.2020, mori dhe shpalli publikisht në të njëjtën ditë ndersa perpiloi me date 05.01.2021;

## **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri E. R** nga babai Sh. dhe nena Z., e lindur K., i lindur me ... ne, me vendbanim në Gjilan, lagja, ka tekryer kater klase të shkolles fillore, penzioner, i martuar, baba i 7 femijve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **ËSHTË FAJTOR**

### **I.**

Sepse në kohë të pa përcaktuar e deri me datë 30.05.2020, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi në mënyrë të paautorizuar pistoletën e llojit ... me numër serik ..., me ngjyrë të zeze, e cila i është konfiskuar nga ana e policisë së Kosovës.

**- Me këtë ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së.**

## II.

Me armen e pershkruar si ne dispozitivin nr. I. te kesaje aktakuze, me date 30.05.2020, rreth ores 13, ne . ka shtene kater here me arme zjarri ne rruge, ne vendin e banueshem, nga nji veture ne kolone, duke shkaktuar rrezik te pergjithshem per qytetaret.

**Me këtë ka kryer veprën penale, shkaktim i rrezikut te pergjithshem nga neni 356 par.1 të KPRK-së.**

**-Andaj, në bazë të nenit 4,38,39,40, 43 ,69, 73,74 , 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe nenit 233 dhe 365 dhe 450 të KPPRK-ës:**

**KONSTATON**

**- Për veprën penale nga dispozitivi I. i këtij aktgjykimi i cakton dënim me gjobë në shumë prej 200,00 (dyqinde) euro.**

**- Për veprën penale nga dispozitivi II. i këtij aktgjykimi i cakton dënim gjobe ne sume prej 150,00 (njqind e pesedhjete) euro.**

**E GJYKON**

**Me dënim unik me gjobë në shumë prej 350,00€ ( treqind e pesedhjete euro) , të cilin gjobë I pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim me gjobë do të shndërrohet në denim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 ( një) ditë burgim.**

**Obligohet** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajë shumën prej nga 20 euro dhe 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

**Konfiskohet:** pistoleta e llojit "Ekol special 99" cal.9 mm, me numer serik EV1292131, me ngjyre te zeze, e pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e njëjta do të asgjësohet.

**A R S Y E T I M**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Renda, me dt. 29.06.2020, ka ngritur aktakuzën PP/I nr. 76/2020, ndaj të akuzuarit Ejup Rashiti , për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 te KPRK-se, dhe veprës penale shkaktim I rrezikut te pergjithshem nga neni 356 paragrafi 1 te KPRK-së,duke kërkuar që pas mbajatjes së

shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave I pandehuri të shpallet fajtor dhe të denohet me dënim meritator sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datën **28.12.2020**, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kësaj gjykate i është dorëzuar një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e lidhur ndërmjet Prokurorisë Themelore në Gjilan DKR-se dhe të pandehurit Ejup Rashiti nga Gjilani, me avokatin mbrojtës sipas autorizmit av. Fjolla Ukshini nga Gjilani.

Gjykata ka aprovuar këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, nga i pandehuri dhe mbrojtësit të tij. Gjykata ka aprovuar këtë marrëveshje për pranimin të fajësisë, për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pa asnjë presion, duke i ditur pasojat e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka pasur parasysh sjelljen e mire të të pandehurit në gjykatë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pa asnjë hezitim , pendimin për veprën e kryer dhe kërkim faljen.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. I pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajë shumën prej nga 20 euro, dhe shumën prej nga 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

Departamenti për Krime të Rënda

Me datë 05.01.2021

**Sekretare juridike**

Fikrete Destani

**Kryetari i trupit gjykues:**

Naser Maliqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.